



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA  
GJYKATA THEMELORE MITROVICË

---

Numri i lëndës: 2023:274050  
Datë: 07.03.2024  
Numri i dokumentit: 05421717

**C.nr.1639/23**

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil**, me gjyqtarin Fuad Haliti, në çështjen juridike kontestimore të paditëses V.M nga Mitrovica të cilën sipas autorizimit e përfaqëson avokat Uvejs Gashi, kundër të paditurës Komuna e Mitrovicës Jugore, me objekt kontesti kompensim i shtesave në pagë në emër të licensimit, jashtë seance me datë 07.03.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**KONSTATOHET** se është tërhequr padia me numër **C.nr.1639/23** e paditëses V.M nga Mitrovica, kundër të paditurës Komuna e Mitrovicës Jugore, me objekt kontesti kompensim i shtesave në pagë në emër të licensimit,

**Arsyetim**

Paditësja V.M nga Mitrovica me datën 27.11.2023 nëpërmes të autorizuarit të saj avokat Uvejs Gashi, pranë kësaj gjykate ka paraqitur padi kundër të paditurës Komuna e Mitrovicës Jugore, për kompensimin e shtesave në pagë në emër të licensimit.

I autorizuari i paditëses me parashtrësën e datës 15.01.2024 ka njoftuar gjykatën se e tërheqin padinë në këtë çështje kontestimore.

Në bazë të nenit 261 paragrafi 1 i LPK-së parashihet që *“Paditësi mund ta tërheqë padinë pa pëlqimin e të paditurit deri në momentin në të cilin i padituri e paraqet në gjykatë përgjigjen në padi.”*

Andaj gjykata duke u bazuar nenit 261 paragrafi 1 i LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË**  
**Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil**  
**C.nr.1639/23, datë: 07.03.2024**

**Gjyqtari**  
**Fuad Haliti**

---

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.